

Në lidhje me kërkesën tuaj, në kuadër të projektit që synon rritjen e përfshirjes politike, sociale dhe ekonomike të të rinjve, për të cilën kërkoni informacion për politikën e bashkisë për të rinjtë të grupmoshës 15-29 vjeç, ju informoj si më poshtë:

Struktura përgjegjëse për politikën rinore është Sektori i Rinisë dhe i Sportit në Drejtorinë e Kulturës Arsimit Rinisë dhe Sportit.

Buxheti i planifikuar për Sektorin e Rinisë dhe Sportit përfshin të rinj të kësaj grupmoshe. Ai përbën 4% të shumës totale të buxhetit.

Promovimi dhe nxitja e pjesëmarrjes aktive e të rinjve në aktivitete sportive dhe sociale si aktorë thelbësorë në zhvillimin e territorit, do të arrihet me anë të aktiviteteve të ndryshme sportive dhe rinore të parashikuara brenda vitit 2019 duke përmendur: zhvillimin e një jave festival shahu me 70 shahistë të moshave të ndryshme, zhvillimi i maratonës së pavarësisë, zhvillimi i një jave beach volley me pjesëmarrjen e sportistëve amatorë dhe profesionistë, zhvillimin e një aktiviteti ndërkombëtar boksi, motivim dhe mirënjohje për 10 sportistët më të mirë, zhvillimi për herë të parë i kinemasë në ambient të hapur ku të rinjtë do mund të shohin filma të ndryshëm në qendër të qytetit. Gjithashtu, brenda këtij kuadri do organizohen edhe 4 aktivitete vullnetarizmi me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të të rinjve në angazhimin e tyre në nisma në të mirë të komunitetit. Informimi i të rinjve rreth vlerave të trashëgimisë kulturore. Gjatë vitit 2019 kjo do arrihet me anë të 6 aktiviteteve informuese dhe promovuese të vlerave të trashëgimisë kulturore në territorin e Bashkisë Shkodër.

Njohja dhe promovimi i letërsisë tek të rinj. Takim dhe njohje me shkrimtare të njohur. Planifikimi i rreth 10 takime të tilla për 2019.

Të punësuar në Bashkinë Shkodër, ka mbi moshën 21, pasi është e lidhur me arsimin Bachelor. Përqindja e të rinjve të punësuar të moshës 21-29 vjeç është 10% e numrit të përgjithshëm të të punësuarve në administratë.

Pranë Bashkisë Shkodër, funksionon qendra rinore "Atelie". Në Bashkinë Shkodër, funksionojnë dhe 10 qendra komunitare, nga të cilat 6 në qytet dhe 4 në njësi administrative, të cilat përveç shërbimeve të tjera ofrojnë dhe shërbime për rininë.

Për buxhetin 2018-2020 mund të klikoni në

http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/p12ok_1536.pdf dhe në atë buxhetit 2019-2021 në http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/argetimi_kultura_dhe_feja_2000.pdf.

Ekziston dhe një keshill rinor i cili ka bërë dhe prezantimin e projektit para keshillit bashkiak

Gj. Kurti

Koordinator i së Drejtës për Informim

Bashkia Shkodër